



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 531 Akti

Nr. 353 Vendimi  
Tiranë, më 3.3.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, më 2.3.2021, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Dritan Hasani**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan T. Hasani, aktualisht me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 15.6.2020 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), z. Lulzim Hamitaj dhe znj. Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Genta Tafa (Bungo).
- 4.** Në mbledhjen e datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Dritan Hasani.
- 5.** Me kërkesën e datës 21.7.2020, të paraqitur nëpërmjet *e-mail-it*, subjekti ka kërkuar përjashtimin e një prej anëtarëve të trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj, për shkak të dyshimit për konflikt interesi, meqënëse ky komisioner ka qenë anëtar i trupit gjykues të subjektit L.H., vëllai i subjektit z. Dritan Hasani. Trupi gjykues i ngritur me vendimin e Komisionit nr. \*\*, datë 22.7.2020 për shqyrtimin e kësaj kërkesë, ka vendosur rrëzimin e saj me vendimin e datës 22.7.2020. Ky vendim iu njoftua subjektit menjëherë.
- 6.** Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 7.** Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 8.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
- 9.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- 10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**11. ILDKPKI-ja**, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**12. DSIK-ja** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**13. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 18.2.2021 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret, si dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**16.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 22.2.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, me anë të *e-mail*-it më 25.2.2021 dhe në rrugë postare më 1.3.2021.

**17.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## II. SEANCA DËGJIMORE

<sup>1</sup> Akti i kontrollit nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2018.

<sup>2</sup> Raporti me nr. \*\*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*, datë 6.1.2021.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 10.8.2018.

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*, datë 26.2.2021.

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 26.02.2021.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 02.03.2021, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

20. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Zoti Dritan Hasani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**25.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**26. Gjendja e llogarisë<sup>6</sup>** rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”, në datën 27.1.2017, në vlerën 1,918,815.85 lekë; pjesa takuese 100%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhurat nga paga si gjyqtar.

### Hetimi<sup>7</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**26.1.** Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017 është 1,918,815.85 lekë. Në këtë llogari derdhet paga e subjektit.

**26.2.** Nga analiza financiare për vitin 2016 deri në datën e plotësimit të deklaratës “Vetting”, e pasqyruar në tabelën më poshtë, konstatohet se subjekti ka patur mundësi për kursimin e këtyre të ardhurave nga paga.

	<b>2016</b>	<b>DV 2017</b>
<b>PASURI</b>	<b>161,773.24</b>	<b>93,627.00</b>
Shtesa/pakësime likuiditete	161,773.24	93,627.00
Likuiditete gjendje	1,825,188.85	1,918,815.85
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>PASURI NETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>161,773.24</b>	<b>93,627.00</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,458,059.00</b>	<b>125,590.00</b>
Të ardhurat e subjektit	1,132,559.00	100,590.00
Të ardhura nga dietat	325,500.00	25,000.00
<b>SHPENZIME</b>	<b>423,692.00</b>	<b>19,837.84</b>
Shpenzime jetese	235,092.00	19,837.84
Shpenzime udhëtimi /TIMS	61,600.00	0.00
Shpenzime qira	127,000.00	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>872,593.76</b>	<b>12,125.16</b>

Shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke iu referuar përgjigjeve të dhëna nga subjekti në pyetësin nr.1. Në analizë nuk është konsideruar shpenzim qiraje në

<sup>6</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.09.2020 drejtuar bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2020.

muajin janar 2017, duke iu referuar kontratës së qirasë të datës 4.6.2016, neni 3, pika 2, ku citohet se: “Pagimi i çmimit të qirasë bëhet javën e parë të muajit pasardhës, për çdo muaj.”

**26.3.** Komisioni ka analizuar edhe veprimet e kryera në këtë llogari, duke konstatuar se burimi i të ardhurave është paga e subjektit nga puna si gjyqtar, tërheqjet e kryera gjatë gjithë periudhës 1.1.2012 - 27.1.2017 janë në shumën 2,490,825.51 lekë, duke mbetur gjendje në llogari në momentin e deklarimit shuma 1,918,815.85 lekë.

<i>Subjekti Dritan Hasani</i>	2012	2013	2014	2015	2016	D. Vetting	2017	2018
<i>Gjendje më 1 janar</i>	120,698.13	106,683.20	688.12	804,585.65	1,661,516.99	1,823,313.53	1,928,815.85	2,587,613.93
<i>Kreditime në total</i>	434,360.86	5.81	1,050,251.26	1,238,320.17	1,450,371.22	125,590.00	1,332,787.27	1,401,708.30
<i>Kreditime paga</i>	434,360.86	5.81	983,251.26	1,178,320.17	1,124,871.22	100,590.00	1,307,787.27	1,219,208.30
<i>Kreditime dieta</i>	0.00	0.00	67,000.00	60,000.00	325,500.00	25,000.00	25,000.00	182,500.00
<i>Debitime</i>	-	-	-246,353.73	-381,388.83	-	-20,131.59	-568,530.78	-626,542.15
<i>Teprica më 31 dhjetor</i>	106,683.20	688.12	804,585.65	1,661,516.99	1,823,313.53	1,928,815.85	2,587,613.93	3,362,843.53

**26.4.** Në përfundim të hetimit Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e kësaj llogarie. Ai ka pasur mundësi financiare për kursimin e këtyre të ardhurave. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nuk lindin dyshime apo paqartësi për këtë pasuri.

**27. Gjendje e llogarisë<sup>8</sup>** rrjedhëse pranë bankës “Credins” në datën 27.1.2017 në shumën 1,963.84 lekë pjesa takuese 100%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhura nga paga si gjyqtar.

#### Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**27.1.** Bazuar në shkresën e “Credins Bank” rezulton se subjekti ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017 në shumën 1,963.84 lekë. Edhe kjo llogari ka të ardhurat nga paga e subjektit.

**27.2.** Nga analiza financiare e kryer nuk rezultojnë mangësi mjetesh monetare.

	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>727,841.12</b>	<b>161,773.24</b>
Shtesa/pakësime likuiditete	727,841.12	161,773.24
Likuiditete gjendje	1,663,415.61	1,825,188.85
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>PASURI NETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>727,841.12</b>	<b>161,773.24</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,217,275.00</b>	<b>1,458,059.00</b>
Të ardhurat e subjektit	1,157,275.00	1,132,559.00
Të ardhura nga dietat	60,000.00	325,500.00
<b>SHPENZIME</b>	<b>407,276.00</b>	<b>423,692.00</b>
Shpenzime jetese	224,276	235,092.00
Shpenzime udhëtimi /TIMS	84,000	61,600.00
Shpenzime qira	99,000	127,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>82,157.88</b>	<b>872,593.76</b>

<sup>8</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: nxjerrje llogarie në “Credins Bank”.

Shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e udhëtimit janë përlogaritur duke iu referuar përgjigjeve të dhëna nga subjekti në pyetësonin nr.1.

**27.3.** “AK Invest” informon për disa transferta me një shtetas me emër Dritan Hasani, por nga krahasimi i të dhënave personale (ID) nuk rezulton të jetë subjekti i rivlerësimit.

**27.4.** Komisioni vlerëson se nuk ka dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë deklaram.

**28. Automjet tip “M – B”<sup>9</sup>**, me targë AA \*\*\* NO, blerë në shumën 650,000 lekë; pjesa takuese 100%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhura nga paga

### Hetimi<sup>10</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**28.1.** Subjekti, me kontratë shitjeje nr. \*\*\* datë 15.3.2016, ka blerë automjetin tip “M- B” (prodhim i vitit 2003) në shumën 650,000 lekë. Në datën 15.3.2016 subjekti ka tërhequr *cash* nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” shumën 732,052 lekë, që është e mjaftueshme për blerjen e mjetit.

**28.2.** Në lidhje me burimin e të ardhurave, konstatohet se subjekti i ka pasur mundësitë financiare.

	15.3.2016
<b>PASURI</b>	<b>92,436</b>
Autoveturë “Benz”	650,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	-557,564.000
Likuiditete gjendje	1,105,851.61
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>92,436</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>283,140</b>
Të ardhurat e subjektit	283,140
Të ardhura nga dietat	16,500
<b>SHPENZIME</b>	<b>107,373</b>
Shpenzime jetese	58,773
Shpenzime udhëtimi/ TIMS	21,600
Shpenzime qiraje	27,000
<b>Mundësia për Kursime</b>	<b>83,330.75</b>

**28.3.** Komisioni ka analizuar edhe dosjen e këtij mjeti. Rezulton se ky mjet është blerë në vlerën 900 euro nga blerësja R.Gj, me kontratë shitjeje mjeti të përdorur, në datën 7.2.2016. Blerësja ka shlyer detyrimet doganore më 25.2.2016, sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen e mjetit në shumën 69,984 lekë. Më pas ky mjet është blerë nga subjekti me kontratën e shitjes së datës 15.3.2016, në shumën 650,000 lekë. Pasi vlerësoi dokumentacionin, Komisioni konstaton se çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti nuk lind dyshime për hetim të mëtejshëm, madje as për konflikt interesi të mundshëm me shitësin. Duket se veprimi financiar është i justifikueshëm.

<sup>9</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë shitjeje nr. \*\*\* datë 15.3.2016.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020 drejtuar bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\*\*prot., datë 28.10.2020; shkresë nr.\*\*\* prot., datë 18.9.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit Rrugor; Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\*\* prot., datë 2.10.2020.

**28.4.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për blerjen e këtij mjete.

**29. Ambient banimi**<sup>11</sup>, “garsoniere”, ndodhur në rrugën “N.J”, Tiranë, marrë me qira 15,000 lekë/muaj.

### **Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**29.1.** Në datën 4.06.2016 subjekti ka lidhur kontratë të thjeshtë qiraje 1-vjeçare për marrjen me qira në shumën 15,000 lekë të një ambienti banimi “garsoniere”, ndodhur në rrugën “N. J”<sup>12</sup>, Tiranë.

**29.2.** Subjekti është pyetur në lidhje me adresat e vendbanimit dhe vendqëndrimit. Në përgjigje të pyetësorit nr.1 ai ka sqaruar se adresa e regjistruar në gjendjen civile është Njësia Bashkiake nr. \*, Bashkia Tiranë, rruga “M.Gj”, nr. \*\*\*. Është vendbanimi i deklaruar sipas ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009. Ai nuk banon aktualisht në këtë banesë, por është deklaruar në fillim, pas transferimit të vendbanimit nga ish-Bashkia Mamurras në Bashkinë Tiranë. Transferimi i vendbanimit në Tiranë është bërë në vitin 2009. Lidhur me vendqëndrimin tjetër, Njësia Bashkiake nr. \*, Tiranë, rruga “N.J”, godina nr. \*\*, shkalla \*\*, subjekti deklaroi se e ka pasur me qira, bazuar në kontratën e datës 4.6.2016, përsëritur në datat 4.6.2017, 4.6.2018 dhe 4.6.2019. Në këtë adresë, subjekti sqaron se ka ndenjur deri në datën 30.11.2019. Pagesa e qirasë ka qenë 15, 000 lekë në muaj, sipas kontratës.

**29.3.** Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka detajuar se, për periudhën janar 2014 deri në muajin maj 2016, adresat e banimit (qëndrimit) janë: hotel “P”, hotel “A”, që ndodhen në sheshin “A.F”, Përmet dhe rruga “P. N. L”, pall. \*\*, sh. \*\*, ap. \*\*, Tiranë. Qëndrimi në hotelet e mësipërme ka qenë i përkohshëm, për shkak të detyrës. Për qëndrimin në hotel subjekti ka deklaruar se nuk ka paguar qira, por ka bërë pagesën pas çdo kohe qëndrimi. Lidhur me adresën në rrugën “P.N.L”, Tiranë, deklaroi se kjo është banesa e vëllait të tij, ku ka qëndruar në mënyrë të përkohshme (me ditë) dhe pa pagesë. Subjekti ka deklaruar se edhe gjatë kryerjes së stazhit profesional (tetor 2012 - korrik 2013) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka qëndruar në shtëpinë e vëllait të tij.

**29.4.** Subjekti është pyetur<sup>13</sup> edhe në lidhje shpenzimet për transportin e tij nga Tirana në Përmet e anasjelltas. Ai ka sqaruar se këto shpenzime janë ndarë me kolegët gjyqtarë, duke përdorur mjetin e tij ose me transport publik, duke vënë në dispozicion disa bileta udhëtimi me autobus.

Komisioni i ka përfshirë këto shpenzime (qira + transport) në analizën financiare.

**29.5.** Në përfundim të hetimit Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklaram. Shpenzimet për qiranë e banimit dhe të transportit janë reflektuar në analizën financiare të kryer.

**30. Automjet tip “M– B”**<sup>14</sup>, me targë TR \*\*\*J, blerë me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 16.9.2009, në vlerën 200,000 lekë, shitur me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 14.6.2013.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhura nga paga.

### **Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**30.1.** Subjekti me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 16.9.2009 ka blerë automjetin tip “M-B” në vlerën 200,000 lekë. Ky automjet është shitur me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 14.6.2013, për vlerën 35,000 lekë.

<sup>11</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë qiraje e datës 4.6.2016.

<sup>12</sup> Subjekti ka sqaruar se ka bërë lapsus në mbiemrin e rrugës, nuk është J, por J.

<sup>13</sup> Shiko Pyetësor nr.1.

<sup>14</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë nr. \*\*\*, datë 16.9.2009; (ii) kontratë nr. \*\*\*\*, datë 14.6.2013.



Në DVP/2012 subjekti deklaroi se ka automjet tip “M- B” të blerë në shumën 500,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit të bërë nga Komisioni më 3.2.2021 subjekti ka qartësuar këtë pasaktësi, duke argumentuar se në deklaratën përpara fillimit të detyrës ka deklaruar për këtë automjet një vlerësim subjektiv të tij, se sa kushtonte automjeti po të shitej, për efekt të rubrikës së vlerës së sendit në atë deklaratë, por kjo nuk është një e ardhur e realizuar. Shitja është bërë në vitin 2013, në vlerën e deklaruar atë vit, në shumën 35, 000 lekë.

**30.2.** Nuk u konstatuan probleme apo dyshime në lidhje me këtë deklaram.

**31.** Komisioni ka kryer analizën financiare për subjektin për gjithë periudhën e ushtrimit të detyrës.

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
1. Pasuri	253,922.92	-53,430.15	102,207.92	3,982.20	182,028.42	646,863.18	727,841.12	811,773.24	2,475,188.85
2. Detyrime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>253,922.92</b>	<b>-53,430.15</b>	<b>102,207.92</b>	<b>3,982.20</b>	<b>182,027.58</b>	<b>646,863.18</b>	<b>727,816.12</b>	<b>811,799.08</b>	<b>2,475,188.85</b>
4. Të ardhura	347,641.82	669,223.00	512,550.00	585,840.00	842,290.00	1,206,613.00	1,217,275.00	1,458,059.00	6,839,491.82
5. Shpenzime	136,620.00	136,620.00	189,413.40	139,548.00	141,024.00	402,998.00	407,276.00	423,692.00	1,977,191.40
<b>Të ardhura neto</b>	<b>211,021.82</b>	<b>532,603.00</b>	<b>323,136.60</b>	<b>446,292.00</b>	<b>701,266.00</b>	<b>803,615.00</b>	<b>809,999.00</b>	<b>1,034,367.00</b>	<b>4,862,300.42</b>
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-42,901.10</b>	<b>586,033.15</b>	<b>220,928.68</b>	<b>442,309.80</b>	<b>519,238.42</b>	<b>156,751.82</b>	<b>82,182.88</b>	<b>222,567.92</b>	<b>2,387,111.57</b>

Përshkrimi	DV/2017	2018	2019
1. Pasuri	95,590.00	666,898.53	775,166.14
2. Detyrime	0.00	0.00	0.00
<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>95,590.00</b>	<b>666,898.53</b>	<b>775,166.14</b>
4. Të ardhura	125,590.00	1,332,626.00	1,401,491.00
5. Shpenzime	19,837.84	478,054.05	470,275.68
<b>Të ardhura neto</b>	<b>105,752.16</b>	<b>854,571.95</b>	<b>931,215.32</b>
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>10,162.16</b>	<b>187,673.42</b>	<b>156,049.18</b>

**31.1.** Nga analiza financiare e kryer nuk rezultojnë mungesa të burimeve financiare në asnjë vit. Në periudhën tetor 2012 – janar 2014 subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, stazhin profesional të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës. Në janar 2014 është emëruar në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

### Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

**32.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**32.1.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në

përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**32.2.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Hasani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**33.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**33.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin<sup>15</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**33.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**33.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese apo fakteve të dala gjatë hetimit.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**34.** Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**35.** Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Hasani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

**36.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

(i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;

Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit të parashikuara në vendimin nr. 36, datë 29. 4.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”<sup>16</sup>;

<sup>15</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

<sup>16</sup> Shih nenin 42/3 i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

(ii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

**36.1.** Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet: (i) formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë nga pikëpamja formale. Në rubrikën “B” për punësimin, të dhënat janë plotësuar nga prilli 2009. (ii) subjekti i rivlerësimit deklaroi se në periudhën prill 2009 - tetor 2010 ka qenë jurist në OSSHE-në Burrel. Në periudhën tetor 2010 – tetor 2012, ai ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës. Në tetor 2012 – janar 2014 deklaroi se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, stazhin profesional të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës. Në janar 2014 është emëruar në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, ku ushtron detyrën edhe aktualisht; (iii) subjekti i rivlerësimit deklaroi se gjatë tre viteve të fundit, ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendimin nr. 22, datë 22.02.2016 të KLD-së ai është deleguar të gjykojë edhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Deklaroi se ka punuar në të drejtën civile, të drejtën penale dhe të drejtën familjare. Nuk është i specializuar në ndonjë fushë të së drejtës; (iv) lidhur me ngarkesën sasiore subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se tre vitet e fundit atij i janë caktuar 571 çështje gjyqësore (388 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe 183 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me delegim). Ai ka përfunduar gjithsej 470 çështje gjyqësore (337 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe 133 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me delegim), duke mbartur vitin e fundit gjithsej 72 çështje gjyqësore (22 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe 50 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë me delegim); (v) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar trajnimet e tij me referencë në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës. Sipas këtij vërtetimi rezultoi se gjyqtari ka marrë pjesë në 16 trajnime.

**36.2.** Nga shqyrtimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ka rezultuar si më poshtë:

**36.2.1. Dokumenti 1:** vendimi nr. \*\*\*\*, datë 14.4.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që i përket paditësit E.B kundër të paditurit Zyra Përmbartimore “B-K” sh.p.k. dhe personit të tretë ZVRPP-së Përmet, me objekt “Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore dhe marrjen e masës së sigurimit për pezullimin e ekzekutimit”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka vendosur rrëzimin e padisë dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë. Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin \*\*\*\*, datë 23.07.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Nuk ka të dhëna nëse ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

**36.2.1.2.** Nga përmbajtja e vendimit rezultoi se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 18.06.2014 dhe gjykimi ka përfunduar me vendim përfundimtar në datën 14.4.2015. Gjykimi ka zgjatur **9 muaj e 26 ditë**, në tejkallim të afatit 20-ditor të përcaktuar nga neni 610 i K.Pr.Civile. Megjithatë, duhet theksuar se kjo e dhënë është nxjerrë bazuar në datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, pasi teksti i vendimit nuk tregon datën kur kjo çështje i është caktuar gjyqtarit D. Hasani.

**36.2.1.3.** Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë të konstatuar. Ka rezultuar nga shpjegimet e subjektit se pas dorëheqjes së gjyqtarit të parë të çështjes, afati 20-ditor ishte ezauruar, por edhe pas caktimit të subjektit si gjyqtar i çështjes, shqyrtimi ka zgjatur nga data 23.6.2014 deri në shpalljen e vendimit në datën 14.4.2015. Subjekti ka shpjeguar se siç rezultoi nga procesverbalet e seancave gjyqësore dhe aktet e dosjes gjyqësore, shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë kërkesat e paditësit për marrjen dhe paraqitjen e provave në formën e kërkuar nga ligji, mosnjoftimi i rregullt i palëve për shkak të letërthirrjes nga shërbimi postar, njoftimi i ekspertit dhe kryerja e ekspertimit, kërkesa e palëve për sqarime plotësuese nga eksperti, mospagesa e shpenzimeve të ekspertit, kërkesa e paditësit për t'u përfaqësuar në gjykim me avokat dhe vetëm në një rast moszhvillimi i seancës, për shkak të

mungesës së gjyqtarit për arsye të një fatkeqësie familjare. Subjekti ka konkluduar se sjellja e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces kanë ndikuar në shtyrjen e seancave gjyqësore.

**36.2.2. Dokumenti 2:** vendimi nr. \*\*\*\*, datë 6.7.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet kundër të pandehurit S. Z, i akuzuar për veprat penale të “vjedhjes, të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit dhe të mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, të parashikuara nga nenet 134/1, 278/2, 278/4 dhe 280 të K.Penal.

**36.2.2.1.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve, me gjykim të shkurtuar, ka vendosur: (i) deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “vjedhjes” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; (ii) deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iii) deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/4 i K. Penal dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim; (iv) deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga neni 280 i K. Penal dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim; (v) në bazë të nenit 55 të K.Penal caktimin e një dënimi të bashkuar prej 6 vjet burgim; (vi) zbritjen e dënimit me 1/3 në bazë të nenit 406 të K. Pr. Penale dhe përfundimisht dënimin e të pandehurit me 4 vjet burgim. Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin \*\*\*\*, datë 18.12.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit ndryshimin e vendimit për masën e dënimit për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/4 i K. Penal, duke e ulur atë në 5 vjet burgim; caktimin e një dënimi të bashkuar prej 5 vjet burgim; uljen e dënimit me 1/3 në bazë të nenit 406/1 të K. Pr. Penale dhe përfundimisht dënimin e të pandehurit me 3 vjet e 4 muaj burgim. Nuk ka të dhëna nëse ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

**36.2.2.2.** Nga përmbajtja e vendimit rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 14.05.2015 dhe gjykimi ka përfunduar me vendim përfundimtar në datën 6.7.2015. Gjykimi ka zgjatur **1 muaj e 22 ditë**. Ky afat është brenda afatit standard 6-mujor, të caktuar nga pika 5, germa “e” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit<sup>17</sup>.

Nuk rezultuan problematika në lidhje me këtë dokument.

**36.2.3. Dokumenti 3:** vendimi nr. \*\*\*\*, datë 27.1.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që i përket paditësit Avokatura e Shtetit kundër të paditurve AKKP Tiranë, V.S etj., dhe personit të tretë ZVRPP-së Përmet, me objekt “anulimi i vendimit të zyrës rajonale të AKKP-së Gjirokastër”.

**36.2.3.1.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, në seancë gjyqësore publike, në prani të paditësit, në mungesë të të paditurve dhe të personit të tretë, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin \*\*\*\*, datë 12.05.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Nuk ka të dhëna nëse ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

**36.2.3.2.** Nga përmbajtja e vendimit rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 21.10.2014 dhe gjykimi ka përfunduar me vendim përfundimtar në datën 27.01.2016. Gjykimi ka zgjatur **1 vit, 3 muaj e 6 ditë**. Kjo kohëzgjatje është në tejkallim të afatit standard 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Megjithatë, duhet theksuar se kjo e dhënë është nxjerrë bazuar në datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, pasi teksti i vendimit nuk tregon datën kur kjo çështje i është caktuar gjyqtarit D. Hasani.

---

<sup>17</sup> Për qëllime të këtij raporti, sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2010 të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

**36.2.3.3.** Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij ai ka sqaruar se shkak kryesor në tejkalimin e afatit standard gjashtëmuor ka qenë kompleksiteti i çështjes, duke qenë se çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve për njohjen dhe kthimin e pronës kërkojnë hetime komplekse dhe marrjen e provave pranë disa institucioneve shtetërore. Në këtë çështje, gjatë gjykimit, janë marrë një sërë provash pranë institucioneve shtetërore me kërkesë të të paditurit, është kryer aktekspertimi, të paditurit nuk janë përcaktuar saktë në kërkesëpadi, duke mos u thirrur si të paditur të gjithë trashëgimtarët e ish-pronarit. Gjithashtu, vdekja gjatë gjykimit e të paditurve ka sjellë shtyrjen e seancave për paraqitjen e aktit të trashëgimisë. Shkak për vonesën gjithashtu ka qenë edhe njoftimi i palëve me shpallje, duke bërë që seancat të caktohen një herë në muaj. Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se natyra e çështjes dhe kryerja e veprimeve procedurale për ndërtimin e rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme të palës së paditur kanë shkaktuar zgjatjen e gjykimit, duke bërë që çështja të mos përfundohet brenda afatit të vlerësimit.

**37.** Nga analiza e përbashkët të tri dokumenteve konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e vendimeve. Organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

**38.** Gjetjet nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short

**38.1. Dosja 1:** çështja penale nr. \*\*\*\*\* regjistri themeltar, datë 15.12.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë kundër të pandehurit Q.Z, i akuzuar për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i K. Penal, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*-2016-\*\*, datë 18.03.2016.**

**38.1.1.** Me shortin e datës **3.3.2016**, ora 14:26:30, çështja i është caktuar subjektit, i deleguar me vendimin nr. 25, datë 21.1.2016 të KLD-së pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Me vendimin e datës 3.3.2016 (brenda ditës), ai ka caktuar seancën gjyqësore më 11.3.2016, ora 10.00, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Caktimi i seancës së parë është bërë më shpejt se afati “të paktën 10 ditë përpara” të përcaktuar nga neni 333/2 i K.Pr.Penale. Në dosje gjenden kopja e shkresës për prokurorin dhe e fletëthirrjes për të pandehurin dhe mbrojtësit.

**38.1.2.** Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit sipas akuzës dhe, pas zbritjes së dënimit me 1/3 për shkak të gjykimit të shkurtuar, dënimin e tij me 3 muaj burgim, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë për 18 muaj bazuar në nenin 59 të K. Penal. Vendimi nuk rezulton të jetë ankimuar nga palët. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i arsyetuar janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Dritan Hasani në sekretarinë gjyqësore në datën 23.3.2016, **pas 5 ditëve** nga shpallja e vendimit, brenda afatit 5- ditor të përcaktuar nga neni 113 i K. Pr. Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej **15 ditë**, në intervalin kohor 3.3.2016 - 18.3.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 9-mujor të caktuar nga pika 5, germa “a” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

**38.1.3.** Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, të cilat janë dokumentuar rregullisht. Në caktimin e seancës së parë nuk është respektuar afati “të paktën 10 ditë përpara”, i caktuar nga neni 333/2 i K. Pr. Penale dhe në dosje nuk ka ndonjë kërkesë të palëve për shkurtimin e këtij afati, sipas nenit 145/2 të K. Pr. Penale. Në caktimin e seancave vijuese janë respektuar afatet ligjore.

**38.1.4.** Vendimi gjyqësor përmban elementet e nenit 383 të K.Pr.Penale. Analizohen elementet e figurës së veprës penale, duke iu referuar nenit 290/1 të K. Penal. Në vijim analizohen kriteret për individualizimin e dënimit dhe caktimin e dënimit, si rrezikshmëria e veprës penale, rrezikshmëria e të pandehurit, shkallën e fajit dhe rrethanat lehtësuese e rënduese.

**38.2. Dosja 2:** çështja civile nr. \*\*\*\*\* regjistri themeltar, datë 18.2.2016 regjistrimi, që i përket paditëses S.Y kundër të paditurit shoqëria “A” sh.p.k., me objekt “detyrim për dorëzimin e

apartamentit të porositur me kontratën e sipërmarrjes”, e përfunduar me vendimin nr. \*-2016-\*\*\*\*, datë 21.7.2016.

**38.2.1.** Me shortin e datës **19.4.2016**, ora 16:16:17 kjo çështje i është caktuar subjektit (i deleguar me vendimin nr. 44, datë 11.4.2016 të KLD-së për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë). Subjekti, me vendimin e datës 19.04.2016 (brenda ditës), ka caktuar seancën përgatitore në datën 16.5.2016, ora 11.55, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Njoftimi i palëve është bërë me fletëhirrjet përkatëse të datës 3.5.2016, pas 14 ditëve nga planifikimi.

**38.2.2.** Gjykata, në përfundim të gjykimit ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë, duke detyruar të paditurin t'i dorëzojë paditëses S.Y apartamentin e banimit me sipërfaqe 77.6 m<sup>2</sup>, si dhe duke rrëzuar padinë për pjesën tjetër. Nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar e drejta e ankimit nga palët.

**38.2.3.** Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar është dorëzuar në sekretari në datën 2.9.2016 - pas **1 muaji e 12 ditëve**, jashtë afatit të parashikuar në nenin 308/2 të K. Pr. Civile. Duket që në tejkalimin e afatit ka ndikuar leja vjetore e gjyqtarëve e muajit gusht, megjithatë ky fakt nuk e justifikon gjyqtarin.

**38.2.4.** Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur **4 muaj e 18 ditë** në intervalin kohor 3.3.2016 - 21.7.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

**38.2.5.** Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, të cilat janë dokumentuar rregullisht. Në caktimin e seancave janë respektuar afatet ligjore. Dokumentacioni në dosje është i plotë. Vendimi gjyqësor përmban elementet e përcaktuara nga nenet 310 dhe 310/1 të K. Pr. Civile. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese – arsyetuese dhe në pjesën urdhëruese. Në arsyetimin ligjor të vendimit gjykata i referohet K. Civil, K. Pr. Civile dhe vendimit unifikues nr.1, datë 6.1.2009 të Gjykatës së Lartë, duke përdorur parimin se kontrata ka forcën e ligjit për palët.

Nga pikëpamja formale, vendimi përmban 5 faqe. Teksti paraqitet me strukturë të thjeshtë. Janë përdorur në tërësi karakteret e gjuhës shqipe dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Referencat në ligj jepen duke cituar dispozitën ligjore me nënvizim. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

**38.3. Dosja 3:** çështja civile nr. \*\*\*\* regjistri themeltar, datë 15.7.2014, që i përket paditësit F.Sh kundër të paditurës Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Këlcyrë, me objekt “konstatim i pavërtetësisë së pjeshme të dokumentit fletëregjistër kombëtar i shtetasve i vitit 2010 dhe vërtetimin e faktit juridik se është i njëjti person”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*\*, datë **29.7.2014**.

**38.3.1.** Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 15.7.2014. Me shortin e datës 14.7.2014 çështja i ka kaluar për gjykim subjektit. Ai, me vendimin e datës 14.7.2014, ka caktuar seancën përgatitore në datën 24.7.2014, ora 09.00. Njoftimi i palëve është bërë me fletëhirrjet përkatëse në datën 17.7.2014, duke mos u respektuar neni 155 i K. P. Civile<sup>18</sup>.

**38.3.2.** Gjykata, në përfundimit të gjykimit, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Në procesverbalin gjyqësor nuk është pasqyruar dispozitivi i vendimit. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga palët.

**38.3.3.** Dosja bashkë me aktet dhe vendimin e arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari në datën 30.7.2014, **pas 1 dite**, brenda afatit të parashikuar në nenin 308/2 të K. Pr. Civile.

---

<sup>18</sup> Neni 155 i K. Pr. Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se “ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.

**38.3.4.** Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej **14 ditë**, në intervalin kohor 15.7.2014 – 29.7.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard kohor 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, germa “e” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

**38.3.5.** Dokumentacioni në dosje është i plotë. Edhe pse në nenin 511 të K. Pr. Civile parashikohet se vendimi për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje dhe në paragrafin e tretë të dispozitivit të vendimit është e pasqyruar kjo, në fakt në dosje janë dy kopje të vendimit për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

**38.3.6.** Vendimi gjyqësor përmban elementet e neneve 310 dhe 310/1 të K. Pr. Civile. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese – arsyetuese dhe në pjesën urdhëruese. Në arsyetimin ligjor të vendimit gjykata i referohet K. Pr. Civile dhe ligjit nr. 10129/2011 “Për gjendjen civile”. Referenca në ligjin “Për gjendjen civile” është bërë në mënyrë të përgjithshme, pa treguar dispozitën konkrete. Nuk është përdorur ndonjë parim i përgjithshëm i së drejtës dhe as ndonjë referencë në jurisprudencën e gjykatave më të larta.

**38.4. Dosja 4:** çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 7.4.2015, që i përket kërkueses M.Sh dhe personave të tretë Bashkia Këlcyrë dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Gjirokastër, me objekt “vërtetimin e faktit juridik të kufijve dhe sipërfaqes së pronave të ish-pronarëve Sh”, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2015.**

**38.4.1.** Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 7.4.2015, fillimisht vetëm me një person të tretë, ZVRPP-në Përmet. Me shortin elektronik të datës 3.4.2015, çështja i është caktuar për gjykim subjektivit. Ai, me vendimin e datës 7.4.2016 (pas 3 ditëve nga marrja e akteve) ka caktuar seancën përgatitore në datën 14.4.2015, ora 11.45. Njoftimi i përfaqësuesit të kërkuesit është bërë me telefon nga sekretaria gjyqësore në datën 10.4.2015, për të cilin është mbajtur procesverbal. Për personin e tretë ZVRPP-në Përmet njoftimi është bërë me fletëthirrjen e datës 10.4.2015. Caktimi i seancës së parë është bërë në shkelje të afatit të nenit 155 të K. Pr. Civile<sup>19</sup>. Gjykata në përfundim të gjykimi ka vendosur pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga palët.

**38.4.2.** Dosja bashkë me aktet dhe vendimin e arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari në datën 27.9.2015 – pas **6 ditëve**, brenda afatit të parashikuar në nenin 308/2 të K. Pr. Civile.

**38.4.3.** Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit Dritan Hasani ka zgjatur gjithsej **5 muaj e 29 ditë**, në intervalin kohor 7.4.2015 – 21.9.2015. Kjo kohëzgjatje është në tejkallim me afatit standard kohor 2-mujor, të përcaktuar në pikën 5, germën “j” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Përgjithësisht janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Seanca e parë është planifikuar më shpejt se 10 ditë, duke mos respektuar nenin 155 të K. Pr. Civile dhe personi i tretë nuk është paraqitur në seancën e parë, ndërsa në seancën vijuese ka kërkuar kohë të njihet me aktet. Gjyqtari ka kryer veprime përgatitore, por ato nuk kanë qenë efektive, pasi vijmësisht gjatë gjykimit ka pasur kërkesa për saktësimin e personave të tretë, që kanë shkaktuar zvarritjen e gjykimit. Pala kërkuese ka shtuar objektin e kërkesës në seancë përgatitore, por ky veprim nuk është formalizuar me vendim të ndërmjetëm të gjyqtarit dhe objekti i shtuar i kërkesës nuk i është njoftuar personave të tretë, që nuk janë paraqitur në seancën përgatitore.

**38.4.4.** Dokumentacioni në dosje është përgjithësisht i plotë, por ka mangësi kryesisht në përmbajtjen e procesverbaleve gjyqësore. Nuk ka akte për njoftimin e vendimit për palët në mungesë. Procesverbalet gjyqësore nuk janë mbajtur sipas kërkesave të nenit 118 të K. Pr. Civile, veçanërisht në lidhje me pasqyrimin e përmbledhjes së saktë të kërkimeve e kundërshtimeve të palës kërkuese e personave të tretë, si dhe të gjitha vendimeve të dhëna nga

---

<sup>19</sup> Neni 155 i K. Pr. Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se “ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”.

gjyqtari për zëvendësimin e personave të tretë dhe të gjykimit në mungesë. Edhe pse procesverbali si akt mbahet nga sekretari, ai duhet të shihet nga gjyqtari përpara nënshkrimit nga ana e tij. Procesverbali është nënshkruar në fund gjyqtari dhe sekretarja gjyqësore.

**38.5. Dosja 5:** çështja civile nr. \*\*\*\* regjistri themeltar, datë 10.9.2014 regjistrimi, që i përket paditësit B. P kundër të paditurit Sh.P, me objekt “zgjidhje martese”, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*\*, datë 4.11.2014.**

**38.5.1.** Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet në datën 10.9.2014. Me shortin e datës 1.9.2014, çështja i ka kaluar për gjykim subjektit. Ai, me vendimin e datës 10.9.2014, ka caktuar seancën përgatitore në datën 24.9.2014, ora 09.30. Njoftimi i palëve për këtë seancë është bërë me letërthirrjet përkatëse nr. \*\*\*\* akti, datë 16.9.2014, duke mos respektuar afatin 10-ditor të nenit 155 të K. Pr. Civile<sup>20</sup>. Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë. Asnjë prej palëve nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

**38.5.2.** Dosja dhe vendimi gjyqësor janë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 12.11.2014, **pas 8 ditëve nga shpallja e tij**, brenda afatit 10-ditor, të përcaktuar nga neni 308, paragrafi 2 i K. Pr. Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur **1 muaj e 24 ditë**, në intervalin kohor 10.9.2014 – 4.11.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 4-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “d” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

**38.5.3.** Përgjithësisht janë kryer veprimet proceduriale për organizimin e procesit gjyqësor. Në planifikimin e seancës së parë gjyqtari nuk ka monitoruar dërgimin e shpejtë të fletëthirrjeve, të cilat janë nisur pas 6 ditëve nga planifikimi dhe rrjedhimisht, është cenuar afati 10-ditor i nenit 155 i K. Pr. Civile. Në procesverbalin gjyqësor nuk është fiksuar përmbajtja e pjesës urdhëruese të vendimit përfundimtar të shpallur nga gjykata.

**39.** Nga të dhënat e dosjes personale, subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 8.7.2008 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2013. Pas studimeve, në datën 23.1.2014 ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendimin nr. 22, datë 23.1.2016 të KLD-së, subjekti delegohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për të shqyrtuar përkatësisht 48 çështje. Aktualisht ai ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

**39.1.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për subjektin është paraqitur 1 ankesë në Inspektoratin e KLD-së (në vitin 2014). Kjo ankesë është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është konstatuar se gjykimi i një çështje gjyqësore ka zgjatur 5 muaj, duke tejkaluar afatin standard 2-mujor. Për këtë shkak, ankesa i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik.

**39.2.** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

**40.** Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

---

<sup>20</sup> Neni 155 i K. Pr. Civile në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017) parashikonte se “ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë”



## 1. Aftësitë profesionale

### a) Njohuritë ligjore

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes gjyqësore. Jep përmbajtjen e normës ligjore materiale dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj. Në disa raste, për interpretimin e normës ligjore, ai përdor parimet e përgjithshme të së drejtës. Në zgjidhjen e çështjeve ai i referohet kuadrit ligjor vendas dhe në ndonjë rast edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë apo të Gjykatës Kushtetuese.

### b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit janë të thjeshta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimeve përfundimtare është e thjeshtë dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore të tij plotësojnë kërkesat bazë të legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

## 2. Aftësitë organizative

### a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka përfunduar gjithsej 311 çështje gjyqësore (31 penale themeli, 21 penale të veçanta, 26 masa sigurimi, 2 kërkesa penale për lejim përgjimi, 188 çështje civile të përgjithshme, 12 civile të veçanta, 39 urdhra ekzekutimi, 8 urdhra mbrojtje dhe 34 çështje familjare). Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë raporton se ai ka përfunduar 130 çështje gjyqësore (3 çështje penale themeli, 2 kërkesa penale, 124 civile të përgjithshme dhe 1 kërkesë civile).

Sipas pikës 3, germa “g”, e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile me palë kundërshtare. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e subjektit të rivlerësimit konstatohet se ngarkesa e tij sasiore ka qenë nën standardin sasior.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga subjekti ka qënë në intervale kohore nga 14 ditë deri në 5 muaj e 29 ditë. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 26 ditë deri në 1 vit, 3 muaj e 6 ditë. Si përfundim, nga këto të dhëna konstatohet se subjekti në 5 raste ka përfunduar gjykimin brenda afateve standard, ndërsa në 3 raste, afati standard është tejkaluar.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti ka patur vonesë vetëm në një rast në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

### b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit merr masat për përfundimin në kohë të çështjeve gjyqësore, ndonëse duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi saktësisë dhe cilësisë së veprimeve procedurale. Në një çështje penale është konstatuar se në caktimin e seancës së parë nuk është respektuar afati “të paktën 10 ditë përpara”, i caktuar nga neni 333/2 i K. Pr. Penale dhe në dosje nuk ka ndonjë kërkesë të palëve për shkurtimin e këtij afati, sipas nenit 145/2 të K. Pr. Penale. Në një çështje civile është konstatuar se seanca e parë është planifikuar më shpejt se 10 ditë, duke mos respektuar nenin 155 të K. Pr. Civile dhe personi i tretë nuk është paraqitur në seancën e parë, ndërsa në seancën vijuese ka kërkuar kohë të njihet me aktet.

Në 3 çështje civile themeli të vëzhguara ai ka kryer veprimet përgatitore, të cilat kanë qenë përgjithësisht formale, pa saktësuar kërkimet e palëve dhe përcaktimin e provave. Në një rast, mungesa e efektivitetit të veprimeve përgatitore ka ndikuar në gjykim, ku janë kryer veprime procedurale gjatë seancave gjyqësore për legjitimitimin e personave të tretë dhe është vendosur për thirrjen e ekspertit, duke sjellë zvarritje të gjykimit.

Gjyqtari nuk ka mbikëqyrur në mënyrën e duhur aktet e njoftimit për seancën e parë. Në një çështje civile është konstatuar se aktet e njoftimit për seancën e parë janë nisur pas 14 ditëve nga planifikimi, megjithatë, në vlerësimin e këtij treguesi duhet mbajtur në konsideratë se gjyqtari ka shqyrtuar këtë çështje me delegim në një gjykatë tjetër, nga ajo që ai ushtron funksionin. Në një çështje tjetër civile, sërish është konstatuar se njoftimet për seancën e parë janë dërguar me vonesë dhe vonesa e dërgimit të njoftimit ka shkelur afatin ligjor të parashikuar nga neni 155 i K. Pr. Civile. Megjithatë, në seancë palët janë paraqitur dhe nuk kanë pasur pretendime për njoftimin. Edhe në një çështje tjetër civile njoftimet për seancën e parë janë nisur pas 6 ditëve nga planifikimi dhe, rrjedhimisht, është cenuar afati 10-ditor i nenit 155 i K. Pr. Civile. Gjatë gjykimit ai reagon shpejt dhe në mënyrën e duhur për të realizuar njoftimin e palëve, duke përdorur mënyrat e njoftimit me telefon, njoftimin nga ekstrakti i QKR-së për shoqëritë tregtare apo njoftimin me shpallje. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë regjistruar audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim.

Në 2 raste është konstatuar se gjyqtari ka shpallur në seancë gjyqësore publike vendimin përfundimtar, por dispozitivi i vendimit nuk është pasqyruar në procesverbal. Në një rast tjetër, pala kërkuese ka shtuar objektin e kërkesës në seancë përgatitore, por ky veprim nuk është formalizuar me vendim të ndërmjetëm të gjyqtarit dhe objekti i shtuar i kërkesës nuk i është njoftuar personave të tretë, që nuk janë paraqitur në seancën përgatitore.

#### c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatuan se ato janë përgjithësisht të rregullta. Në çdo dosje civile janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paditësit, aktet e njoftimit të palëve dhe kërkesat me shkrim të palëve. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën e çeljes, si dhe veprimet që kryhen në seancë, duke plotësuar kriteret e nenit 118 të K. Pr. Civile. Në 2 raste dispozitivi i vendimit përfundimtar nuk është bërë pjesë e procesverbalit gjyqësor. Aktet në të gjitha dosjet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale civile duke u bërë lehtësisht të shfytëzueshme për palët. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### a) Etika në punë

Subjekti ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 8.7.2008 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2013. Pas studimeve, në datën 23.1.2014 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendimin nr. 22,

datë 22.2.2016 është deleguar në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Aktualisht mban detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për subjektin ka vetëm 1 ankesë për zvarritje gjykimi dhe pas verifikimit ajo i është regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për subjektin, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

#### b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë gjetur raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementeve të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, edhe pse janë konstatuar raste të mosrespektimit të rregullave procedurale, si në lidhje me afatet e gjykimit dhe me mosrespektimin e orarit të fillimit të seancave ato nuk kanë sjellë pasoja në cenimin e standardit të gjykatës së paanshme. Megjithatë saktësia dhe cilësia e këtyre veprimeve ka vend për t'u përmirësuar.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari subjekti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2013. Për shkak të funksionit, ai i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të kësaj shkolle. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë në 16 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 29 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trivjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në dhoma dhe seksione.

### **41. Denoncime**

#### 41.1. Denoncim i paraqitur nga Agjencia e Trajtimit të Kredive<sup>21</sup>

Në denoncim pretendohet se:

- subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 179 të K. Pr. Civile, pasi pala paditëse nuk ka qenë prezent në momentin e çeljes së seancës;
- subjekti ka pezulluar procesin për 15 minuta duke treguar njëanshmëri dhe favorizim të palës paditëse;
- subjekti nuk ka thirrur ekspert, pavarësisht kërkesës së ATK-së;
- nuk ka rregulluar ndërgjyqësinë pasi nuk ka thirrur në proces z. Y.Xh;
- pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar kërkimin e tij, ndërkohë që në seancë përgatitore gjyqtari ka lejuar vijimin e procesit, duke mos e konsideruar padinë me të meta;
- kemi të bëjmë me gjë të gjykuar.

**41.1.1.** Është pyetur<sup>22</sup> subjekti në lidhje me këto pretendime të denoncuesit. Në përgjigjen e tij të detajuar ai ka sqaruar se: (i) *“...lidhur me seancën e datës 14.12.2020, ku ka ngritur pretendimet ATK-ja, parashtroj se seanca ishte planifikuar në orën 12:00 dhe është çelur në orën 12:09:44, për shkak se në këtë ditë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka funksionuar me një sekretar gjyqësor, pasi dy sekretaret e tjera kanë qenë në periudhën e karantinës, si pasojë e virusit COVID-19. Sekretari gjyqësor ka kryer veprimet në sistemin ICMIS dhe RDA për shtyrjen e një seance tjetër gjyqësore, të planifikuar në orën 12:00 nga një gjyqtar tjetër i gjykatës, i cili ka qenë në karantinë dhe më pas ka kryer veprimet për çeljen e seancës dhe thirrjen e palëve, në çështjen në shqyrtim.*

*Pas çeljes së seancës është konstatuar mungesa e paditësit dhe prania e përfaqësuesit të ATK-së. Ky i fundit ka kërkuar që të procedohet sipas ligjit. Bazuar në nenin 175/1 të K.Pr.Civile është vendosur ndërprerja e seancës për të verifikuar shkaqet e mosparaqitjes së paditësit dhe, pasi sekretari gjyqësor është kthyer në sallën ku zhvillohej seanca, ka paraqitur procesverbalin e njoftimit me telefon në datën 14.12.2020, të mbajtur nga kancelari dhe sekretari, ku rezulton se paditësi kishte njoftuar me mjete elektronike (telefon) se nuk mund të paraqitej në seancë në orarin e caktuar (ora 12:00) për shkak të një problemi me makinën dhe kishte kërkuar shtyrjen e seancës për disa minuta (shih faqe 221 të dosjes gjyqësore). Duke vlerësuar natyrën e shkakut të paraqitur nga paditësi është vendosur që seanca të ndërpritet për rreth 30 minuta. Paditësi ka marrë pjesë rregullisht në seancat e mëparshme gjyqësore, duke u paraqitur në orën e caktuar.*

*Lidhur me moszbatimin e nenit 179/2 të K.Pr.Civile (pushimin e gjykimit) në momentin që nuk ka qenë i pranishëm paditësi vlerësoj se paditësi kishte njoftuar gjykatën për një shkak të ligjshëm, që kishte penguar atë për të mos u paraqitur në orën e caktuar të seancës. Paditësi kishte njoftuar se gjatë rrugës për t’u paraqitur në gjykatë, kishte pasur probleme me automjetin (sipas padisë paditësi jeton në Këlcyrë) dhe pavarësisht se ky shkak nuk ishte i provuar në çastin e parashtrimit të tij, përbën shkak të ligjshëm për ndërprerjen e seancës për disa minuta, kjo duke vlerësuar sjelljen e mëparshme të palës, natyrën e shkakut dhe faktin që është kërkuar ndërprerja e seancës për disa minuta. Veprimet për ndërprerjen e seancës dhe vazhdimin e saj pas rreth 24 minutash (seanca është ndërprerë në orën 12:17:45 dhe është riçelur në orën 12:41:38), janë kryer për të verifikuar shkaqet e mungesës së palës paditëse, sipas nenit 175/1 të K. Pr. Civile;*

*(ii) në lidhje me kërkesën e ATK-së për thirrjen e ekspertit ose ekspertëve dhe thirrjen në gjykim të shtetasit Y. Xh parashtroj se këto kërkesa janë rrëzuar si kërkesa të paraqitura jashtë afatit ligjor. ATK-ja ka paraqitur kërkesë me shkrim për thirrjen e ekspertit, duke e paraqitur në sekretarinë e gjykatës në datën 19.11.2020 (faqja 235 e dosjes gjyqësore), ndërsa kërkesën për thirrjen në gjykim të Y.Xh e ka paraqitur përfaqësuesi i saj, me gojë, në seancën e datës*

<sup>21</sup> Nr. \*\*\*, datë 18.12.2020.

<sup>22</sup> Shiko pyetësorin e datës 3.2.2021.

14.12.2020. Këto kërkesa nuk janë paraqitur në deklaratën e mbrotjes së ATK-së. Të dyja kërkesat janë rrëzuar bazuar në nenin 158/7 dhe 192/3 të K. Pr. Civile, pasi janë kërkuar nga pala pas nxjerrjes së urdhërit për caktimin e seancës gjyqësore. Lidhur me thirrjes e shtetasit Y. Xh si palë e paditur theksoj se gjykata nuk mund të thërrasë kryesisht një person si palë të paditur në një proces civil, pasi kjo i përket vetëm disponibilitetit të palës paditëse;

(iii) lidhur me provat theksoj se nuk është gjykata që përcakton provat e palës paditëse apo palës së paditur. Gjykata vlerëson padinë dhe prapësimet mbi bazën e provave të paraqitura nga palët. Kërkesëpatria përmbante elementet e parashikuara në nenet 154/a e 156 të K. Pr. Civile dhe nuk ka qenë rasti për njoftimin e paditësit për plotësimin e të metave apo kthimin me të meta të padisë;

(iv) lidhur me pretendimin “për gjë të gjykuar”, parashtroj se ky pretendim i ATK-së është ngritur në deklaratën e mbrotjes dhe gjykata, duke qenë se është prapësim që lidhet me bazueshmërinë e padisë (themelin e padisë), shprehet me vendim përfundimtar, sipas nenit 126 të K. Pr. Civile dhe jo me vendime të ndërmjetme. Duke qenë se për këtë çështje është vendosur pushimi i gjykimit me vendimin nr. \*\*\*\*, datë 28.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nuk është marrë në shqyrtim dhe prapësimi i ATK-së për “gjë të gjykuar”.

Në mbështetje të shpjegimeve të veta subjekti ka paraqitur kopje të dosjes gjyqësore.

#### 41.2. Denoncim i paraqitur nga J.J<sup>23</sup>

Denoncuesi pretendon se vendimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2018 i dhënë nga subjekti nuk është një vendim i drejtë dhe se subjekti ka kryer shkelje të rënda procedurale si më poshtë:

- (i) ka vendosur kthimin e kundërpadisë, duke e quajtur si padi të re në një kohë që ishte plotësim i të metave të kundërpadisë;
- (ii) në të njëjtën seancë ka dhënë vendimin përfundimtar, duke mos i dhënë të drejtë palës për të përgatitur konkluzionet përfundimtare dhe mbrojtjen e saj;
- (iii) lejoi zhvillimin e seancave pa u njoftuar palët në gjykim për seancën gjyqësore dhe konkretisht A.J;
- (iv) lejoi ekspert ligjor në konflikt interesi.

**41.2.1.** Është pyetur<sup>24</sup> subjekti në lidhje me këto pretendime të denoncuesit. Në përgjigjen e tij të detajuar ai ka sqaruar se: (i) “...lidhur me kthimin e kundërpadisë me të meta, ky vendim është pjesë e dosjes gjyqësore dhe është arsyetuar më vete. Kundërpatria është kthyer me të meta, për shkak se të paditurit kundërpaditës nuk kanë përmbushur detyrat e lëna nga gjykata për plotësimin e të metave të kundërpadisë, që kishin të bënin me adresat e njoftimit të të paditurve në kundërpadi dhe përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të personit, që kërkonin të thërrisnin si të paditur. Kundërpatria nuk është vlerësuar padi e re, por është orientuar pala e paditur se mund të ngrejë padi me vete (shih paragrafin 9 të vendimit përfundimtar). Pala e paditur ka paraqitur shkresën e datës 19.11.2018, por nuk saktësoi nëse kjo shkresë përbënte plotësim të metash të kundërpadisë apo kundërpadi e re (shih procesverbalin e seancës së datës 20.11.2018). Në paragrafin 9 të vendimit përfundimtar është arsyetuar se kjo shkresë nuk plotësonte elementët e kundërpadisë, sipas nenit 160 të K. Pr. Civile dhe për pasojë, nuk është marrë në shqyrtim si kundërpadi. Pala e paditur ka pasur të gjithë mundësinë dhe kohën e nevojshme për paraqitjen e kundërpadisë dhe plotësimin e të metave të saj, kur procesi gjyqësor ka zgjatuar për rreth dy vjet, por ka paraqitur kërkesa të shpeshta për shtyrjen e seancave dhe nuk ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykata për plotësimin e të metave të kundërpadisë edhe pas zgjatjes së afatit. Sjellja e të paditurve nuk ka qenë në përputhje me nenin 3 të K. Pr. Civile, pasi nuk kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga procesi civil.

(ii) pas kthimit të kundërpadisë me të meta, në seancën e datës 20.11.2018 është vazhduar

<sup>23</sup> Nr. \*\*\*, datë 8.1.2019.

<sup>24</sup> Shiko pyetësorin e datës 3.2.2021.

shqyrtimi gjyqësor, me dëgjimin e kërkesave të palëve dhe pasi janë marrë vendimet për mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë, administrimin e provave dhe mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, është dëgjuar diskutimi përfundimtar i palës paditëse dhe janë ftuar të paditurit për të paraqitur diskutimin përfundimtar. Të paditurit nuk kanë kërkuar kohë për të paraqitur diskutimin përfundimtar me shkrim, por kanë paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës; kërkesë e cila është rrëzuar si e papranueshme. Me pas, gjykata është terhequr në dhomën e këshillimit dhe ka vendosur të shpallë vendimin atë ditë, në orën 14:30. Në momentin e shpalljes së vendimit nuk kanë qenë të pranishëm të paditurit J. J e K. J, ndërsa për të paditurin A.J ishte marrë vendimi i vazhdimit të gjykimit në mungesë. I padituri A.J ka pasur dijeni për seancat gjyqësore dhe nuk është paraqitur duke mos paraqitur dhe shkaqe të ligjshme për mungesën e tij (shih seancën e datës 26.10.2017, 7.12.2017, etj) dhe ka marrë pjesë në disa seanca gjyqësore (Shih seancën e datës 20.2.2018 etj.) Vendimi për vazhdimin e gjykimit në mungesë të të paditurit A. J është marrë në përputhje me nenin 179 të K. Pr. Civile.

(iii) lidhur me ekspertin theksoj se fillimisht është caktuar ekspert z. M. H, i cili ka hequr dorë nga kryerja e detyrës, për shkak të fillimit të marrëdhënieve të punës pranë një organi shtetëror (shih procesverbalin e datës 9.11.2017). Më tej është caktuar ekspert z. K.K, i cili, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga kryerja e ekspertimit për shkak të problemeve gjatë përpilimit të aktit të ekspertimit; kërkesë që është pranuar (shih procesverbalin e seancës së datës 20.2.2018) dhe ekspert është caktuar z. Xh.Ll. Pas paraqitjes së mendimit me shkrim nga ky ekspert, të paditurit kërkuan përjashtimin e tij, duke pretenduar se është takuar me përfaqësuesen e paditëses (ka qëndruar në zyrën e saj, duke paraqitur dhe fotografi). Kërkesa për përjashtimin e ekspertit është rrëzuar (shih paragrafin 17 të vendimit përfundimtar). Fakti që eksperti takohet me përfaqësuesin e palës paditëse është vlerësuar se nuk përbën shkak për përjashtimin e ekspertit, sipas nenit 224/c e 72 të K. Pr. Civile, pasi është detyrim i ekspertit që të takojë palët dhe të përfshijë në mendim, vërejtjet e tyre, bazuar në nenin 228/2 të këtij Kodi. Në mungesë të provave të tjera, që vërtetojnë njërin nga shkaqet e parashikuara në nenin 72 të K. Pr. Civile, kërkesa për përjashtimin e ekspertit është vlerësuar e pabazuar në ligj. Kjo çështje është në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila nuk ka marrë një vendim përfundimtar lidhur me ankimin e palëve.”  
Subjekti ka bashkëlidhur një kopje të dosjes gjyqësore.

#### **41.3. Denoncim i paraqitur nga V.P<sup>25</sup>**

Denoncuesi ankohet se subjekti se bashku me një subjekt tjetër nuk marrin në shqyrtim të gjithë kërkesat e tij të cilat i ka bërë me shkrim. Denoncuesi shprehet se çështja është në gjykim.

Komisioni nuk mund të shqyrtojë këtë ankim për sa kohë gjykimi rezulton të mos ketë përfunduar. Gjithashtu nga denoncuesi nuk janë paraqitur prova/dokumenta për të vërtetuar pretendimet e tij.

#### **41.4. Denoncim i paraqitur nga N. H<sup>26</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti ka marrë vendime në shkelje flagrante të ligjit, duke kërkuar të verifikohet themeli i këtyre dy vendimmarrjeve.

Komisioni, pasi analizoi ankesën si dhe vendimet e depozituar prej denoncuesit, vlerëson se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit. Kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Komisioni çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit:

<sup>25</sup> Nr. \*\*\*, datë 3.7.2019 dhe nr. 8096, datë 4.12.2018

<sup>26</sup> Nr. \*\*\*\*, datë 3.4.2018.

“Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”, dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**41.5.** Pranë Komisionit janë paraqitur edhe denoncime nga (i) A. B<sup>27</sup>; (ii) Sh.H<sup>28</sup>; (iii) A. H<sup>29</sup>; (iv) K.H<sup>30</sup>.

Denoncuesit ankohen për disa subjekte rivlerësimi, përfshirë dhe subjektin Dritan Hasani.

Komisioni vlerëson se bazuar në dosjet e ankesës nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**42.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

**42.1** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

**42.2** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Hasani.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe

---

<sup>27</sup> Nr. \*\*\*, datë 20.7.2018.

<sup>28</sup> Nr. \*\*\*, datë 19.9.2018.

<sup>29</sup> Nr. \*\*\*, datë 6.11.2018.

<sup>30</sup> Nr. \*\*\*, datë 20.12.2017.

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 3.3.2021

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**VALBONA SANXHAKTARI**  
**Kryesuese**

**LULZIM HAMITAJ**  
**Anëtar**

**GENTA Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*